

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		17/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
07	052103	232M	



REPUBLIKA E KOSOVËS
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Glllogoc
 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë



Bazuar në nenin 22, par.1 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenin 27, par 1 dhe 2 të rregullorës (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë - Sektori i Pronës lidhur me mbikëqyrjen e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës paraqet këtë:

R A P O R T

Zyrtarja për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim, në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale dhe Rregullores (QRK) NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, pas verifikimit të gjendjes në teren raporton te gjeturat e saj mbi gjendjen faktike lidhur me përmbushjen e kontratës Nr.01-463-60666, dt.18.10.2016 Kryetarit të Komunes së Drenasit:

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.01-463-60666, dt.18.10.2016, është e lidhur në mes të Komuna e Drenasit e përfaqësuar nga ish-Kryetari i Komunës z.Nexhat Demaku në njërin anë dhe N.P.SII "THAQI", me seli në Komoran, me nr te biznesit 810045303, te cilën në kohën e nënshkrimit të kontratës e ka përfaqësuar Rexhep Thaqi ndërsa tani e përfaqëson Enver Thaqi nga Llapushniku në anën tjetër, pronë të cilën e merr në shfrytëzim afatëgjatë për 45 (katërdhjetë e pesë) vite pronën komunale, parcelën nr.244-3, sipërfaqe 0.20 ha, ndërsa në Certifikatën e pronësisë 1869 m² në vendin e quajtur Stoponica, zona kadastrale-Komoran.

Obligimet ndërmjet palëve kontraktuese kanë filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate 18.10.2016 dhe shfrytëzuesi i pronës komunale ka qenë i obliguar të i përmbahet obligimeve të përcaktuara me kontratë.

- Pas verifikimit në Kadastër dhe Gjeodezi konstatohet se e drejta e shfrytëzimit të pronës komunale në emër të shfrytëzuesit ende nuk është e regjistruar në Kadaster RDPP. Lidhur me këtë çështje këtij biznesi nga Zyra e Kryetarit me datë 12.05.2026 i është shqiptuar vërejtje me shkrim, shfrytëzuesi i pronës komunale ka parashtruar kërkesë me nr.01-070/01-20276 të dt.02.06.2026, pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për regjistrim të pronës komunale dhe është në procedurë.
- Me qëllim të verifikimit të kontratës dhe gjendjes së pronës, kemi dalur në vendshiqim me dt.20.05.2026 ku kemi konstatuar se shfrytëzuesi i pronës komunale e ka ndërtuar objektin e përshtatshëm në të cilin ushtrohet veprimtaria e njëjtë siç është paraparë në nenin 2 të kontratës "Veprimtaria primare prodhim i zdrukthtaris me elemente të ndërtimtarisë ndërsa

veprimtaria sekondare tregtia tjetër me pakic me shitore jo të specializuara”, poashtu edhe shitjen e materialit ndërtimor. Sipas deklarimeve të shfrytëzuesit të pronës komunale vlera e investimeve brenda kësaj pronë ka arritur vlerën 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro.

- Sipas Vendimit për Leje ndërtimore me nr.351-820 të dt.23.08.2005 subjektit në fjalë i lejohet ndërtimi i objektit afarist “Zdruktitari” me dimensione 18.50x11.15 me etazhitet P+0.
- Bazuar në evidencën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, gjendjen e kartelës nr.1319, në emër të shfrytëzuesit të pronës komunale (Enver Thaqi) është paguar qiraja, ashtu siç është përcaktuar në nenin 4 të kontratës, shfrytëzuesi i pronës komunale është i rregullt në pagesat e qirasë.
- Sa i përket numërit të punëtorëve, shfrytëzuesi i pronës komunale ka deklaruar listën me pesë (5) punëtor dhe pronari 6 të punësuar në këtë biznes.

Pas verifikimit të kontratës numër 01-463-60666 e datës 18.10.2016, gjendjes së pronës në parcelen numër 244-3 zona kadastrale Komoran, evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe duke iu referuar nenit 8 të kësaj kontrate i cili specifikon qartë se çdo gjë që nuk është parapar sipas kësaj kontrate, do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi tokën ndërtimore, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore.

Bazuar në kontratën me Nr.01-463-60666, dt.18.10.2016,, gjendjes së pronës në parcelën numër 244-3, zona kadastrale Komoran , evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe verifikimeve të kryera në teren, konstatohet gjendja faktike e pronës sipas të dhënave të paraqitura në dokumentacionin përkatës. Të gjitha të gjeturat janë evidentuar në këtë raport në përputhje me dokumentacionin e bashkëngjitur dhe gjendjen e konstatuar në teren.

Zyrtare për Menaxhimin e Pronës Komunale

Dafina Leku







181/101/2016
01 463 60666



K O N T R A T Ë

MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJAT PRONËN E PALUJTSHME TË KOMUNËS.

E LIDHUR MË DATËN 30.09.2016 NË MES :

1. Komunës së Drenasit të cilin e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Nexhat Demaku (në tekstin e mëtejme: QIRADHËNËSI).
dhe
2. N.P.SH "THAQI" me seli në Komaran, Komuna e Glogocit, me numër të biznesit 80015976, numër fiskal 600161997 të cilin e përfaqëson drejtori Rexhep Thaqi nga Llapushniku, Komuna e Glogocit, me numër personal 1010344375 lëshuar në MPB në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: QIRAMARRËSI).

I

BAZA JURIDIKE:

I. Baza juridike e kësaj kontratë është nenit 14.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 9 paragrafi 5 i Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 18 paragrafi 6 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 463-39797 të datës 30.07.2015 mbi miratimin paraprak të pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim personave fizikë e juridik, Raporti i Komisionit vlerësuese për dërgimin e ofertës së përzgjedhur 12 Nr.353-37929 të datës 07.07.2016 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 463-34432 të datës 20.06.2016 mbi aprovimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues.

OBJEKTI I KONTRATËS:

II.

Është dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajjtshme të komunës në zonën kadastrale Komoran, në ngastrën nr.244-3 kullosë - nr.1574/3, në sipërfaqe prej 2000 m², me kulturë tokë ndërtimore në të cilën është ndërtuar objekti për ushtrimin e veprimtarisë primare prodhimi i zdrukthëtarisë me elemente të ndërtimtarisë ndërsa veprimtarin sekondare tregtia tjetër me pakicë në shitore jo të specializuara.

AFATI KOHOR:

III

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajjtshme të komunës sipas pikës dy (II) të kësaj kontrate është katërdhjetëepesë (45) vite, nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate me mundësi të shkëputjes duke respektuar afatin e tërheqjes prej gjashtë (6) muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga njëra palë kontraktuese, për realizimin e ndonjë projekti me interes publik në kuptim të Planit Zhvillimor Komunal të aprovuar nga Kuvendi i Komunes së Qiradhenesit.

ÇMIMI:

IV.

Çmimi për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajjtshme të komunës sipas pikës dy (II) të kësaj kontrate caktohet në lartësi prej 0.50 €, për m² në vit, në bazë të rekomandimit të komisionit për për zgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme duke filluar nga data 01.10.2016 e gjer me skadimin e kësaj kontrate e atë në fillim të vitit me së largu gjer me datën pesë (5) të muajt janar në të kundërtën do të ndërpritet kontrata në mënyrë të njëanshëm pa paralajmërim.

OBLIGIMET RECIPROKE:

V

Shfrytëzuesi afatgjatë i tokës së paluajjtshme të komunës, pajtohet se parcelën e marr në shfrytëzim afatgjatë do ta shfrytëzojë sipas kriterëve të konkursit publik siç janë :

1. Në këtë parcelë do të ndërtohet objektin tërësisht sipas kushteve tekniko - urbanistike dhe lejes për ndërtim që i kërkohet nga organi kompetent i Komunës së Drenasit sipas Konkursit publik për të njëjtin destinim në të kundërtën do të ndërpritet kontrata në mënyrë të njëanshme.
2. Që të fillojë punën menjëherë;
3. Që të marr lejen për përdorim të objektit ;

4. Shfrytëzuesi i tokës obligohet që ç'do vit të paguaj qiranë për marrjen e tokës në shfrytëzim, në xhirrollogarinë e Komunës së Drenasit nr: 1000650070000022 kodi 40-pranë Autoritetit Bankar të Kosovës.

5. Pas shkëputjes së kontratës përkatësisht kalimit të afatit të kontratës shfrytëzuesi i tokës së paluajtshme të komunës obligohet që tokën e dhënë në shfrytëzim afatgjatë të kthen tokën në gjendje që e ka marrë.

6. Të ndikoj në rritjen e vlerës së pronës të dhënë në shfrytëzim afatgjatë.

Dhënësi i tokës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë obligohet që toka e dhënë në shfrytëzim afatgjatë, të mos ketë ndonjë kontest pronësor, të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta, të jetë në pajtim me planin zhvillimor urban dhe rregullues si dhe të dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim pa pengesa shfrytëzuesit.

VI.

Palët kontraktuese u pajtuan se çmimi për shfrytëzimin e tokës komunale sipas kësaj kontrate nuk do të ndryshon nëse shfrytëzuesi paguan çmimin e ofruar sipas konkursit publik në një kiste në të kundërtën do të ndryshohet në bazë të Vendimit të BQK-së, nëse monedha që është e aplikueshme në Republikën Kosovës do të ketë rënie në berzë në % e rënies.

VII

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët kontraktuese të bënë regjistrimin katastral në (RDPP) regjistrat e palujtëshmerive si shfrytëzues i përkohshëm i kësaj toke.

VIII

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshme të tokës komunale është kontratë formale që duhet të përpilohet me shkrim. Çdo gjë që nuk është paraparë sipas kësaj kontrate, do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi tokën ndërtimore, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore.

IX

Shfrytëzuesi i tokës i bartë shpenzimet e mirëmbajtjes së rregullt të cilat janë të nevojshme për të pasur mundësi të funksionimit si dhe të paguaj shpenzimet e rrymës, të ngrohjes, të ujit dhe komunalit tjera në funksion të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të këtij objekti që do të ndërtohet në këtë tokë ndërtimore dhe pas përfundimit obligohet që tokën ndërtimore ta kthej në gjendje që e ka pranuar.

X

Në rast kontesti sipas kësaj kontrate, kompetente për vendosje do të jetë Gjykata kompetente.

Kjo kontratë është e hartuar në katër ekzemplar të njëjtë prej të cilave nga dy kopje për palët kontraktuese.

PALËT KONTAKTUESE :

QIRAMARRËSI:

DREJTORI
Rexhep Thaqi



QIRADHËNËSI:

Kryetari i Komunës
Z. Nexhat Demaku





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Gllgocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 463-344/32 dt 10.06 2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të komunës Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllgocit) si dhe propozimit të komisionit për dhënjën e pronave në shfrytëzim nr.12 463-30345 në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2016 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË**

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit Nr.12-463-30345 për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për përiudhen afatgjate sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjën e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kriterëve të konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive, çmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Ipet në shfrytëzim Prona e paluajtshme e Komunës me sa vijon:

- Emri i përfituesit: N.P.SH "Thaqi"
- Zona Katastrale :Komoran, parcela nr.1574/3
- Vlera investive :30.000,00 euro
- Numri i punëtorve : 6 vende pune
- Gjithësejt Sipërfaqja e pranuar :0.15 ha
- Afati i shfrytëzimit të pronës është 45 vjet.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit që të jap pëlqimin për lokacionin e caktuar

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Kadastrës, Gjeodezi dhe Pronë të bënë bartjen e kësaj palujtshmërie në emër të shfrytëzuesit në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite në regjistrin e RDPP në emër të firmes kontraktuse N.P.SH "Thaqi"


Neni 6

Obligohet Kryetari i Komunës që pas hyrjes në fuqi të keti vendimi të lidh kontrat me firmen përfituse

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimi i MAPL-së

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj

Në bazë të nenit 33,37,38 dhe 48 alineja 1të Ligjit të ndërtimit ("nr.2004/15 ") ,dhe në bazë të nenit 138 të Statuit të Kuvendi Komunal të Glllogocit dhe në bazë të kërkesës së Rexhep Thaçit nga Llapushniku,Drejtoria për Urbanizëm,Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit KK Glllogocit,merr këtë:

A K T V E N D I M

I. **I LEJOHET** Rexhep Thaçit nga Llapushniku lejen për NDËRTIMIN e objektit afarist "Zdruktharisë" në parcelen kadastrale.nr.244/3 dhe 1574/3 në vendin e quajtur"Stopanica" komuna kadastrale Komoran më dimenzone 18.50x11.15 etazh P+0

II.Kjo leje e ndërtimit vlën deri sa të jetë në fuqi kontrata mbi dhënjën e tokës në shfrytëzim

III.Investitori është i obliguar:

a)që për të gjitha tu përmbahet dispozitave Ligjore dhe lejes urbanistike si dhe projektit në bazë të cilës ipet kjo leje,

b)që në afat prej 8 ditësh para fillimit të punimeve të lajmeroi inspektionin e ndërtimitarisë mbi fillimin e punimeve,

c)që më rastin e kryerjes së themeleve të lajmeroi më shkrim organin që ka dhenë lejen e ndërtimit,se themelet janë ndërtuara në pajtim me lejen dhe sipas projektit dhe për këtë ta siguroi më shkrim,

ç)që pas kryerjes së punimeve të paraqesë kërkesën për kontrollim teknik të objektit dhe marrjës së lejes për përdorim të objektit.

IV.Kjo leje e ndërtimit abergohet nese investitori nuk fillon punimet në afat prej 2 viti nga dita e dhenjës së kësaj leje.

V.Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e lëshimit.

A r s y e t i m i

Rexhep Thaçi nga Llapushnik më kërkesën e vëtë nr.351-820 të datës 22.08.2005 ka kerkuar nga Drejtoria për Urbanizëm,Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit që ti lëshohet lejen e ndërtimit të objektit afarist në ngastrën kadastrale nr.244/3 dhe 1575/3 në vendin e quajtur"Stopanica"Komuna kadastrale Komoran ashtu siq u theksua në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Bashkanëgjitur më kërkes sjell:

-Lejen urbanistike nr.353-480 dt.27.06.2005

-Projektin në tre ekzemplar

-Kontrata mbi dhenjen e tokes komunale të përkohshme nr.421-274 dt.10.05.2005

Drejtoria për Urbanizëm,Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit në Glllogoc,duke shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionet u konstatuar së janë plotësuar kushte për marrjën e lejes.

Andaj me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për marrjen e aktvendimit paguhet taksa ne shume prej 5€

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi mund të paraqite ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjës,të Kryeshefi i Ekzekutivit të KK Glllogocit.Ankesa dergohet përmesë kësaj Drejtorie më taksa administrative pre 5€.

AKTVENDIMI I DERGOHET:

-Investitorit,në dosje dhe Arhivës.

U VENDOS NË DREJTORIN PËR URBANIZËM,PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT KK GLLGOC,NR.351-820 dt.23.08.2005

Referenti:

Feriz Qorri
Feriz Qorri



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		12/05/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	16898	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna e Drenasit/Glogocit
Zyra e Kryetarit



Datë:	08.5.2026
Për/za/to:	N.P.SH. "THAQI" me seli në Komoran
Nga /od/from:	Ramiz Uldrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit
Cc.	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Tema/subjekat/subject:	Vërejtje për përmbushjen e obligimeve kontraktuale të kontratës Nr.01-463-60666 dt:18.10.2016

Të nderuar,

Ashtu siç jeni në dijeni edhe ju Komuna e Drenasit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Drenasit në atë kohëz.Nexhat Demaku ka lidhur kontratë mbi dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronë e palujtshme të Komunës Nr. 01-463-60666 dt:18.10.2016 e lidhur në mes Komunës së Drenasit dhe N.P.SH. "THAQI" me seli në Komoran , pjesën e ngastrës /parcelës nr.244-3, sipërfaqe 0.20 ha, në vendin e quajtur Stopanica , zona kadastrale Komoran në të cilën do të ndërtohet objekt për ushtrimin e veprimtarisë – veprimtaria primare prodhim i zdrukthtarisë me elemente të ndërtimtarisë ndërsa veprimtaria sekondare tjetria tjetër me pakic me shitore jo të specializuara, për një periudhë prej katërdhjetëepesë (45) vite.

Bazuar në këtë kontratë (kontrata Nr.01-463-60666 e datës 18.10.2016) më saktësisht obligimeve kontraktuale të cilat dalin nga e njëjta ndër të tjera është paraparë edhe lista e numrit të punëtorëve të cilët duhet të angazhohen nga juaj, me gjithsej gjashtë (6) vende pune.

Nga ky numër i përgjithshëm sipas raportit të Drejtorisë për Gjcodezi, Kadastër dhe Pronë- Sektori i Pronës në kuadër të mbikëqyrjes së kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës i datës 31.12.2025 me nr.07-052/01-55264 është konstatuar se sipas gjendjes faktike në teren dhe konstatimeve të bëra nga ana juaj në firmën tuaj janë të angazhuar 5 punëtor dhe pronari 6 të punësuar, dhe në përgjithësi janë të plotësuar obligimet kontraktuale të kontratës së lartcekur, përjashtimisht asaj që ju si shfrytëzues i pronës ende nuk e keni të regjistruar

të drejtën e shfrytëzimit të pronës komunale në emrin tuaj në kadastër RDPP, **për çka edhe udhëzoheni të paraqiteni në Drejtorin për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë për eliminimin e këtyre të mertave** në mënyrë që ashtu sic parashihet në kontratën e lartecekur detyrimet e së cilës me vullnet të plotë i keni pranuar si të tilla të përmbushen në përpikmëri përmes përmbushjes të së cilave do të arrihet edhe eliminimi i veprimeve të tjera procedurale për të cilat ne si institucion në një situatë të tillë do të detyrohemi të i ndërmarrim.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		02/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtejca	Vlera
01	070/01	-	20276

NGA:	N.P.SH "THAQI", Komoran.
PËR:	Komuna Drenas, zyra e Kryetarit të Komunës.
LËNDA:	Kërkesë
DATE:	02.06.2026.

Të nderuar/a,

Kompania N.P.SH "THAQI" me seli në Komoran të cilën e përfaqëson Enver Thaqi, me datën 30.09.2016 ka lidhur kontratën me numër të protokollit 01-463-60666 mbi dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të Komunës.

Pas udhëzimeve nga ana e zyrës së Kryetarit të Komunës, ne me datën 22.05.2026 kemi bërë kërkesën pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë me numër të protokollit 070-70/01-18665 për regjistrimin e kësaj kontrate në RDPP, por nga ana e Drejtorisë më është kërkuar të bëhet verifikimi i Kontratës nga ana e organit i cili e ka nxjerrë.

Bazuar në të dhënat e lartëshënuara kërkojmë nga ana juaj verifikimin e kësaj kontrate, për të vazhduar tutje me procedurën për regjistrim në RDPP.

Bashkangjitur gjeni:

Kontratën.

Informimin nga DGKP.

Me respekt:

Enver Thaqi.



044 285 524



Lista e Punëtorëve

Periudha 2026

Numri Fiskal	810045303	Kontakti	ENVER-THAQI
Tatimpaguesi	Enver Thaqi B.I.	Adresa	xheladin gashi, p.n
Regjioni	PRISHTINË 2	Tel	
Lloji Kompanisë	Individual	Aktiviteti	Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthtarisë tjetër ndërtuese

Nr.	Emri	Nr. Personal	Primare	MUAJT											
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ALBIN THAQI	1248692142	JO	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-	-
2	EDONIS THAQI	1243123204	JO	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-	-
3	RION KASTRATI	1247642443	JO	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-	-
4	SAMI MORINA	1014748968	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
5	SAMI THAQI	1010349873	JO	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-	-

G j e n d i a n ë K a r t e l ë

Nr i kartel. _____

1319

Firma _____

N.P.SH./„THAQI”

Veprimtaria _____

OERAMARRËS 10+45vit.20

Emri _____

REXHEP

Adresa _____

KOMARAN

Mbiemri _____

THAQI

ID	Data e rexistr	Nr i urdhënt	Pershkrimi	Debi	Kredi	Salido
1319	18.10.2016	463-60666	Ngark. i qeras sipas kont.dt.18.10.2016	45,000.00	0.00	0.00
1319	10.05.2005	421-279	Ngark. i qeras 10.05.05-10.05.2015	40,000.00	0.00	0.00
1319	30.06.2006	2563	Paguar sipas rap.2563/VI	0.00	2,000.00	0.00
1319	24.04.2007	1911	Paguar sipas rap.1911/IV	0.00	2,000.00	0.00
1319	19.08.2008	107948	Paguar sipas rap.107948/VIII	0.00	2,000.00	0.00
1319	28.12.2009	15384147	Paguar sipas rap.15384147/XII	0.00	2,000.00	0.00
1319	13.04.2010	31	Paguar sipas rap.31/IV	0.00	2,000.00	0.00
1319	19.07.11	84	Paguar sipas rap.84/VII	0.00	1,000.00	0.00
1319	31.12.2012	123	Paguar sipas rapo.123/XII	0.00	3,000.00	0.00
1319	23.12.2013	150	Paguar sipas rapo.150/XII	0.00	2,000.00	0.00
1319	24.12.2014	177 177	Paguar sipas fakt.nr.177/XII-2014	0.00	2,000.00	0.00
1319	30.05.2017	50	Paguar sipas fakt.50/V-2017	0.00	22,000.00	0.00
1319	26.07.2017	87	Paguar sipas fakt.nr.87/VII-2017	0.00	1,158.00	0.00

1319	12.01.2018	99	Paguar sipas fakt.nr.99/I	0.00	1.000.00	0.00
1319	11.01.2019	310	Paguar sipas fakt.310/I	0.00	1.000.00	0.00
1319	10.01.2020	113	Paguar sipas fakt.nr.113/I	0.00	1.000.00	0.00
1319	04.02.2026	326000003	Paguar sipas fakt.nr.326000003/II	0.00	1.000.00	0.00
Totalli i Debis		85.000.00	Totalli i Kredis:	45.168.00	Totalli i salidos	39.832.00

REPublika e Kosovës KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		16 10 61 20 26	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
07	052103	22995	



REPUBLIKA E KOSOVËS
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë



Bazuar në nenin 22, par.1 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenin 27, par 1 dhe 2 të rregullorës (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë - Sektori i Pronës lidhur me mbikëqyrjen e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës paraqet këtë:

R A P O R T

Zyrtarja për menaxhimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim, në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale dhe Rregullores (QRK) NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, pas verifikimit të gjendjes në teren raporton të gjeturat e saj mbi gjendjen faktike lidhur me përmbushjen e kontratës Nr.01-400/01-51545 dt.26.11.2020, Kryetarit të Komunes së Drenasit:

Kontrata mbi dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.01-400/01-51545, dt.26.11.2020, është e lidhur në mes të Komuna e Drenasit e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci në njërën anë dhe ELKOS SH.P.K, me seli në Komoran, me nr të biznesit 810413584, të cilën e përfaqëson Servete Abazi në anën tjetër, përmes së cilës e marr në shfrytëzim afatëgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën komunale, parcelën nr.202-1, sipërfaqe 37.10m², në vendin e quajtur “Fshat-Fshat”,zona kadastrale-Komoran.

- Pas verifikimit në Kadastër dhe Gjeodezi konstatohet se e drejta e shfrytëzimit të pronës komunale në emër të shfrytëzuesit (ELKOS SH.P.K) është e regjistruar në Kadastër RDPP, në pjesën tekstuale dhe grafike.
- Me qëllim të verifikimit të kontratës dhe gjendjes së pronës, kemi dalur në vendshiqim me dt. 05.06.2026 dhe kemi konstatuar se shfrytëzuesi i pronës komunale në objektin që e ka ndërtuar në tokën e marrë në shfrytëzim për “Qender Tregtare, Afarizëm, Depo për Grumbullim Agrar”. Kemi konstatuar se biznesi është aktiv dhe sipas deklarimeve të personit të autorizuar zhvillohet veprimtaria “Qender Tregtare, Afarizëm, Depo për Grumbullim Agrar” ashtu siq e përcakton neni 4 i kontratës.
- Bazuar në Vendimin për Leje Ndërtimore 08.Nr.351/01-1564 të dt.11.06.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në bazë të së cilës shfrytëzuesit afatëgjatë të pronës komunale i lejohet ndërtimi i objektit afarist Qender tregtare dhe depo me grumbullim agrar me etazhitet P+1 me sipërfaqe bruto të ndërtimit S=2215.96 m². Vija ndërtimore e objektit të jetë jo më afër se 10m nga rruga rajonale R102 sipas ligjeve në fuqi.

- Pas verifikimit të kontratës dhe gjendjes së pronës, personi i autorizuar ka deklaruar se vlera e investimeve brenda kësaj prone ka arritur vlerën 775,951.36 euro, ku shfrytëzuesi i pronës komunale ka ndërtuar objektin e përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së përcaktuar në kontratë, gjendja e objektit pasqyrohet përmes fotografive të bëra në vendshiqim.
- Bazuar në evidencën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, gjendjen e kartelës nr.1361, të marrë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në emer të shfrytëzuesit të pronës komunale (Servete Abazi) është paguar qiraja, ashtu siç është përcaktuar me nenin 5 të kontratës, shfrytëzuesi i pronës komunale është i rregulltë në pagesat e qirasë.
- Sa i përket numërit të punëtorëve, shfrytëzuesi i pronës komunale ka deklaruar listën me 35 (tridhjetë e pesë) punëtor të punësuar në këtë biznes.
- Pas verifikimit të kontratës me Nr.01-400/01-51545, dt.26.11.2020, gjendjes së pronës në parcelën nr.202-1, zona kadastrale-Komorani dhe në bazë të evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa vlerësojmë se shfrytëzuesi i pronës komunale është brenda kriterëve kontraktuale.

Pas verifikimit të kontratës Nr.01-400/01-51545, dt.26.11.2020, gjendjes së pronës në parcelën numër 202-1, zona kadastrale Komoran, evidencës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe verifikimeve të kryera në terren, konstatohet gjendja faktike e pronës sipas të dhënave të paraqitura në dokumentacionin përkatës. Të gjitha të gjeturat janë evidentuar në këtë raport në përputhje me dokumentacionin e bashkëngjitur dhe gjendjen e konstatuar në terren.

Zyrtare për Menaxhimin e Pronës Komunale

Dafina Leku





REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		26/11	2020
Nj. Org.	Numër	Shlojca	Vlera
01-	400/01	57845	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Glogoc
Opština Glogovac
Municipal Assembly

Duke u bazuar në nenin 19 paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur me nenin 22 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr.(QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatëgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020 për zgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme, Vendimin e Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47385 dt. 30.10.2020, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr.020-828/3 datë 16.11.2020, Kryetari i Komunës lidh kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese:

KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1.

Palët

- 1) Komuna e Glogocit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe
- 2) Elkos shpk e regjistruar në zyrën e bizneseve në Prishtinë, me zbatimin e ligjit për numrin unik identifikues të biznesit ka këtë NUI: 810413584, Komuna e Pejës, e përfaqësuar nga Servete Abazi, Drejtor, në tekstin në vijim "Operatori Ekonomik".

Neni 2.

Lënda e Kontratës:

Duke ju nënshtuar kushteve të parashtruara në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues i jep në shfrytëzim afatëgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite operatorit ekonomik, dhe operatori

R.L.

S.D.

ekonomik merr në shfrytëzim afatgjatë nga Autoriteti Kontraktues, parcelën kadastrale Nr.P-70314035-00202-1, pronë shoqërore e Kuvendit të Komunës së Gillogocit.

Neni 3.

Autoriteti Kontraktues është pronar i pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, në tekstin në vijim e referuar si "objekti i kontratës".

Neni 4.

5.1 Objekti i kontratës është i paradestinuuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitete afariste të bizneseve, për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal. Operatori Ekonomik do të shfrytëzoj objektin e kontratës për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste - ndërtimin Qendër Tregtare, Afarizëm, Depo për Grumbullim Agrar, sipas projekt propozimit të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

5.2 Operatori Ekonomik obligohet që ti përmbahet planit dinamik realizues (plani dinamik me 01-Nr.070-50544 të datës 19.11.2020, Vendimi i Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47385 datë 30.10.2020, Konfirmimi i ligjshëm të aktit të Komunës së Gillogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr.020-828/3 datë 16.11.2020, Njoftimi publik 01-Nr.462/01-38720 datë 16.09.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale, Raporti i vlerësimit të ofertave 01-Nr.052/03-43188 datë 09.10.2020, Njoftimi publik 01-Nr.462/01-43186 datë 09.10.2020, janë pjesë e kësaj kontrate).

5.3 Operatori Ekonomik obligohet të fillojë punën në afat prej 4 muajsh, nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 5.

Operatori Ekonomik obligohet të bëjë pagesën e shfrytëzimit afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës siç është paraqitur në projektin ofertues me nr.070-41035, të datës 29.09.2020, në shumën prej 1000.00 vjetore.

Neni 6.

6.1. Autoriteti Kontraktues pajtohet t'i ofroj çasje të lirë operatorit ekonomik në objektin e kësaj kontrate, për tërë periudhën e shfrytëzimit të tij.

DL

S.P

Neni 7.

Objekti i kontratës

7.1. Autoriteti Kontraktues i'a jep në shfrytëzim pronën Operatorit Ekonomik, ndërsa Operatori Ekonomik e merr në shfrytëzim nga Autoriteti Kontraktues objektin e përshkruar si vijon:

7.2. Fleta poseduese

7.3. Parcela

7.4. Madhësia e tokës

7.5. Të dhëna tjera në lidhje me tokën.

Neni 8.

Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm:

8.1. Duke iu nënshtruar edhe afateve të tjera të kësaj Kontrate, kohëzgjatja e kësaj Kontratë për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

8.2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës e ka të drejtën e marrjes vendimit për shkëputjen e kontratës. Me këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

8.3. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit.

8.4. Nëse Operatori Ekonomik nuk e plotëson ndonjë kusht paraprak, Autoriteti Kontraktues mund të anulojë këtë Kontratë, duke e njoftuar me shkrim Operatorin Ekonomik për këtë dhe të kërkoj dëmshpërblimin sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Pl.

S.P.

8.5. Operatori Ekonomik ka të drejtë që, në diskrecionin e tij të vetëm dhe të plotë, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, ta anulojë këtë Kontratë para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për dëmshpërblim, duke e njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues për synimin e tij për ta anuluar këtë Kontratë. Operatori Ekonomik duhet ta njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës më të cilën synon ta anulojë këtë Kontratë.

Neni 9.

9.1 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

9.2 Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

9.3. Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Neni 10.

Mbikëqyrja e kontratave:

10.1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.

10.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Neni 11.

Operatori Ekonomik obligohet ti përmbahet vendimit të Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47385 i datës 30.10.2020, si dhe me projektin ofertues me nr.070-41035, të datës 29.09.2020, në

Raj.

L. J.

rastë të mos përmbushjes së tyre Kryetari i Komunës ka të drejtë ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 12.

Operatori Ekonomik obligohet që pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ti përmbahet afatit të paraparë në planin dinamik, të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore për fillimin e punimeve, duke siguruar shfrytëzimin apo destinimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm.

Neni 13.

Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do ti zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje, dhe në rast se këtë nuk mund të arrijnë atëherë kontestet do të zgjidhen në Gjykatën Kompetente.

Neni 14.

Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplar të mjaftuar për palën kontraktuese, palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

Neni 15.

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrim nga ana e palëve kontraktuese.

Kryetari i Komunës
z. Ramiz Lladri



ELKOS sh.p.k.
Znj. Serveza Gbazi
sh.p.k.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



12 Nr. 662/01-47385 dt. 30/10/ 2020

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40,të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenin 5, nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 19 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13, 14, 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188, të datës 09.10.2020 për zgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Kompanin Elkos shpk

Neni 1

Miratohet Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes së interesit, Kompanisë Elkos shpk në parcelën kadastrale nr.P-70314035-00202-1, në sipërfaqe të përgjithshme 3710.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fshat-Fshat", Zona Kadastrale Komoran, në pronësi të Komunës së Glllogocit.

Neni 2

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik dhe përfitimi financiar dhe ekonomik i Komunës së Glllogocit nga prona komunale.

Neni 4

Pas miratimit të vendimit përfundimtar nga ana e Kuvendit të Komunës, autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratë me fituesin.

Neni 5

Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 6

Prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën I të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

Neni 9

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



08-Nr 351/01-15644 dt. 13.04.2021

Në bazë të neneve 14, 15, 19, 20 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe aplikacionit të ELKOS Group me përfaqësues Servete Abazi nga Peja, të paraqitur me numër të protokollimit 08-Nr.351/01-15644 të datës 13.04.2021, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Servete Abazi, ELKOS Group,		
Adresa:	Rr. "Nexhdet Basha", Pejë		
Telefoni:	049779299	Emaili:	

